

I Hyrje

Qëllimi i tekstit para juve është që të prezantojë rezultatet preliminare të studimit të fizibilitetit lidhur me zhvillimin e arsimit të lartë në rajonin e komunave të Preshevës dhe Bujanocit. Zhvillimi i arsimit të lartë në këto komuna është motivuar jo vetëm nga nevoja që bashkësisë shqiptare t'iu mundësohet arsimim i lartë në gjuhën amtare, por edhe me dëshirën që me rritjen e nivelit të përgjithshëm të arsimit të popullatës të kontribuohet si në zhvillimin ekonomik të regjionit, ashtu edhe në bashkëpunimin dhe integrimin në mes të grupeve etnike (Shqiptarëve, Romëve dhe Serbëve). Në vitin akademik 2009/10 ka filluar punën enti i shkollimit të lartë në Medvegjë me mësim në gjuhën serbe dhe shqipe. Hapja e programeve dygjuhësore të arsimit të lartë në Medvegjë ka treguar për një varg çështjesh të hapura kur bëhet fjalë për shkollimin e lartë për përfaqësuesit e pakicave nacionale shqiptare në jug të Serbisë. Prandaj Trupi koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (në tekstin e mëtejme Trupi koordinues), që në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit ka bërë të mundur hapjen e programeve të shkollimit të lartë në Medvegjë, ka vendosur qasje tjetër për zgjidhjen e çështjes së shkollimit të lartë në Bujanoc dhe Medvegjë. Në biseda me përfaqësuesit e Ministrisë së arsimit, përkrahjen e të cilit për realizimin e këtij projekti e theksojmë qysh në faqet e para, është konkluduar se është e domosdoshme të bëhet analiza e palëve të interesuara, partnerëve të ardhshëm, si dhe për të shqyrtuar mundësinë kur është në pyetje arsimit i lartë në regjion. Duke pasur parasysh që Trupi koordinues nuk ka kapacitete për realizimin e një hulumtimi kaq rëndësishëm dhe përfshirës, është vendosur që bartësit e analizës të jenë organizatat joqeveritare të cilat në fushat e përmendura kanë përvojë shumëvjeçare.

Qendra për rezistencë jo të dhunshme (në tekstin e mëtejme CNO), organizatë joqeveritare nga Beogradi e cila me vite realizon projekte në jug të Serbisë, duke përfshirë edhe analiza të numërta, ka inicuar aktivitete lidhur me realizimin e studimit. Në bashkëpunim me Trupin koordinues, përfaqësuesit e CNO kanë shkruar projektin "Reforma e politikës arsimore në jug të Serbisë" dhe kanë konkuruar për mjete tek Fondi për shoqëri të hapur. Fondi për shoqëri të hapur (në tekstin e mëtejme FOS) e ka përkrahur projektin dhe ka financuar realizimin e hulumtimit në shumë prej 2.070.000 dinarë, që ka mundësuar fillimin e punës në studimin e fizibilitetit. Duke pasur parasysh që studimi i parashikuar nënkupton analizën e mundësive të hapjes së studimeve të arsimit të lartë që iu nënshtrohet rregullativave komplekse juridike dhe procedurave specifike për sistemin arsimor, është paraqitur nevoja për kyçjen e organizatës me përvojë dhe ekspertizë në njohjen e sistemit arsimor të Serbisë. CNO për këtë arsye ka kontaktuar **Qendrën për politika arsimore** (në tekstin e mëtejme COP) si bartëse e pjesës profesionale të studimit. Ekipi hulumtues i COP-së u formua në gusht të vitit 2009 dhe është përbërë nga: **Jana Baqeviq** (koordinatore e ekipit hulumtues), **Ivana Bozhiq**, **Vanja Ivosheviq**, **Marija Mitroviq**, **Ivan Rajkoviq**, **Jasmina Selanoviq** dhe **Tajana Brkanoviq** (CNO) . **Mihaillo Babin** dhe **Iskra Maksimoviq** nga Fakulteti për ekonomi, financa dhe administratë, të Univerzitetit Singidunum në Beograd (në tekstin e mëtejme FEFA), kanë marrë pjesë në hartimin e aspekteve ekonomike dhe financiare të analizës. Studimet e rasteve lidhur me zgjidhjet e arsimit të lartë për pakica në

Mal të Zi, Maqedoni dhe Vojvodinë i kanë zbatuar **Tajana Brkanoviq (CNO), Tanja Ivosheviq, Ivana Stanojev (CNO)** dhe **Norbert Shabiq (COP)**.

Për CNO koordinator i projektit ka qenë **Sillobodan Boshkoviq**, kurse asistente Ivana Stanojev. Për punën e papengueshme dhe kualitative në komunat Preshevë dhe Bujanoc janë përkujdesur koordinatorët lokal **Rahim Saliu** dhe **Predrag Belej**, si dhe **Gazmend Selmani**. Duke krijuar ekipin i cili në mënyrën më të mirë të mundshme do të përfshijë të gjithë partnerët, CNO, COP dhe Trupin koordinues, për ndihmë iu kanë drejtuar misionit të OSBE-së në Serbi dhe Zyrës së përfaqësuesit të Lartë për pakica kombëtare me seli në Hagë. Komesari i lartë për pakica kombëtare jep kontributin e vet për studimin në pikëpamje të ofrimit të ekspertizës, mendimit profesional, dhe ka angazhuar dhe autorizuar konsultantin Sebastian Dvorak (**Sebastian Dëorack**) t'i japë kontributin e vet ekipit për hartimin e studimit. Recensionin e studimit e ka bërë Paola Petriq, kurse lekturën Ana Lukoviq. Si përfaqësuese e Trupit Koordinues në hartimin e studimit ka marrë pjesë Daniela Nenadiq. Studimi që është para juve është rezultat i bashkëpunimit të vërtetë dhe partneritetit të sektorit joqeveritar, institucioneve shtetërore dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare.

Vizita preliminare e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, në të cilat, para dy anëtareve të ekipit hulumtues, kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Qendrës për rezistencë të padhunshme dhe OSBE-së, është zbatuar në shtator të vitit 2009. Hulumtimi në terren në këto tri komuna, si dhe pjesët e hulumtimit në Beograd, janë zbatuar gjatë tetorit dhe nëntorit. Këto pjesë të hulumtimit kanë përfshirë intervista të thella (biseda) me autorët kryesor në procesin e zhvillimit të arsimit të lartë për pakica në jug të Serbisë: përfaqësuesit e Qeverisë së Serbisë, Ministrive dhe Trupit koordinues; përfaqësuesit e bashkësive ndërkombëtare; përfaqësuesve të bashkësisë akademike (institucioneve të shkollimit të lartë). Përveç intervistave, janë realizuar fokus-grupet me nxënësit e shkollave të mesme në territorin e Preshevës dhe Bujanocit, prindërve të tyre, si dhe grupet e biznesmenëve. Pjesa tjetër e hulumtimit ka përfshirë studimin e rastit në Vojvodinë, Mal të Zi dhe Maqedoni. Studimet e rasteve japin pasqyrë të kornizës së arsimit në gjuhët e pakicave, si dhe analizojnë në cilën mënyrë zgjidhjet e aplikuarat i kanë kontribuar zgjidhjes së problemit të arsimit të pakicave dhe integritetit dhe ndërtimit të marrëdhënies brend

a shoqërisë etnikisht të llojllojshme. Studimet e rasteve janë bazuar në mbledhjen e informatave ekzistuese dhe analizave, si dhe intervistave me aktorët kryesor të zbatuara në terren, në janar dhe shkurt të vitit 2010. Realizimi i studimit të rastit nuk do të ishte i mundur pa përkrahjen e Departamentit për zhvillim ndërkombëtar (Department for International Development – DfID) Mbretërisë së bashkuar, të cilave me këtë rast iu falënderohemi për përkrahjen e dhënë. Fondi Ballkanik për demokraci (Balkan Trust for Democracy- BTD) gjithashtu dukshëm e ka ndihmuar zbatimin e studimit.

II Korniza teoriko-metodologjike dhe përshkrimi i hulumtimit

Ekipi hulumtues është orientuar për qasje më kualitative që nënkupton një lloj të caktuar të **etnografisë**, respektivisht qëndrime të zgjata në terren të ekipit hulumtues dhe intervistim të thellë të përfaqësuesve të ndryshëm të bashkësisë lokale, si dhe aktorëve tjerë të rëndësishëm, respektivisht palëve të interesuara. Arsyeja për zgjedhjen e një metodologjie të tillë është pikërisht në atë se ekipi hulumtues nuk ka dashur që studimi të rezultojë me një zgjidhje të parëvokuar që më vonë do të ishte "e imponuar". Përkundrazi, është dëshiruar që të grumbullohen dhe analizohen **problemet, mendimet dhe qëndrimet** e palëve të interesuara, e pastaj, në bazë të rezultateve të kësaj pjese të hulumtimit, përshkruajnë zgjidhje të ndryshme për zhvillim të arsimit të lartë në gjuhën e pakicave në jug të Serbisë.

Pjesa më e madhe e hulumtimit gjatë vizitave në terren në Preshevë, Bujanoc, Medvegjë dhe Nish është bërë gjatë tetorit dhe nëntorit të vitit 2009. Numri i përgjithshëm i daljeve në terren, duke përfshirë edhe vizitën preliminare, ka qenë gjashtë, përderisa numri i përgjithshëm i ditëve të kaluara në terren ka qenë 20. Numri i përgjithshëm i bashkëfolësve në hulumtim është më shumë se 100. Në biseda janë aplikuar dy teknika: intervista dhe fokus grupe. Shumica e grupeve të anketuara është intervistuar, përderisa fokus grupet janë aplikuar në rastet kur ka qenë e rëndësishme të intervistohet numër sa më i madh i të anketuarve nga një grup i caktuar-respektivisht, kur ishte fjala për nxënësit e shkollave të mesme dhe gjimnazeve, prindërve, studentëve në departamentet në Medvegjë dhe biznesmenëve. Në intervistim është përdorur teknika e **intervistimit të thellë**. Kjo do të thotë që kanë qenë të udhëhequr në bazë të pyetësorit, por qëllimi ka qenë që bashkëbiseduesve t'iu mundësohet që t'i shprehin qëndrimet dhe botëkuptimet e veta në mënyrë të lirë, ashtu që intervistat të mund të përcjellin rrjedhë sa më "natyrore".

Intervistat e bëra gjatë vizitave në terren mund të ndahen në tri grupe: në njërin janë intervistat e bëra në Beograd, me përfaqësuesit e Qeverisë së Serbisë dhe pjesëmarrësve tjerë në marrjen e vendimeve; në të dytën janë intervistat e bëra me personelin e Univerzitetit në Nish (në Nish dhe në Medvegjë) dhe me studentët në Medvegjë; dhe në të tretën janë intervistat e bëra në vetë terrenin, respektivisht gjatë vizitave hulumtuese në Preshevë dhe Bujanoc.

Janë definuar tri grupe të përgjigjeve të të anketuarve: problemet, zgjidhjet dhe qëndrimet. Propozimet për zgjidhjen e arsimit të lartë janë ndarë dhe janë përdorur si bazë për krijimin e zgjidhjeve të mundshme të arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc. Gjithsesi, është me rëndësi të theksohet se përgjigjet e prezantuara këtu përbëjnë vetëm përmbledhjen e elementeve më të rëndësishme dhe më të shpeshta; analiza më detale është përmbajtur në tekstin e përgjithshëm të studimit.

III Analiza e rezultateve

Pika rreth së cilës gati të gjithë të anketuarit pajtohen është se *problemet* kryesore në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë janë të **natyrës ekonomike**. Në mes të problemeve të para

është shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik të komunave, dhe me to e ndërlidhur papunësia e lartë. Këto dy probleme shkaktojnë "largimin e të arsimuarve", respektivisht ajo që është përjetuar si shkallë e lartë e migrimit nga komunat drejt pjesëve të zhvilluara të regjioneve, në Serbi ose vendet fqinje.

Mungesa e arsimit të lartë në gjuhën shqipe është identifikuar gjithashtu si pjesë përbërëse e këtij problemi. Në fakt, mungesa e mundësive që arsimin e lartë t'a fitojnë në gjuhën amtare për disa pjesëtarë të bashkësisë shqiptare do të thotë se mbeten me kualifikime të ulëta (dhe për këtë arsye edhe me mundësi më të vogla për punësim), kurse për shumë të rinj do të thotë se arsimin e lartë e arrijnë në qendrat univerzitare ku ajo ekziston në gjuhën shqipe- Tetovë, Prishtinë ose Tiranë. Të anketuarit theksojnë se shumë të rinj edhe mbeten në qendrat ku studiojnë, si për shkak të mundësive më të mëdha të punësimit, ashtu edhe për shkak se kanë probleme me nostrifikimin e diplomave në Serbi, posaçërisht atyre që kanë vulë të Kosovës.

Shumë të anketuar ndërlidhen edhe për problemin e **marrëdhënieve ndëretnike**, para së gjithash në mes të pjesëtarëve të bashkësisë serbe dhe shqiptare. Edhe pse ekziston konsensus rreth përjashtimit të konfliktit, të anketuarit shpesh theksojnë se kjo është për shkak të jetës së ndarë, posaçërisht arsimit. Pikërisht për këtë, shkollimi i ndarë është shprehur si një nga problemet kryesore.

Për shkak të temës së studimit, por edhe problemeve të identifikuar, të anketuarit kryesisht janë pajtuar se **zhvillimi i arsimit të lartë në gjuhën shqipe në komunat Preshevë dhe Bujanoc** është *zgjidhja* më e rëndësishme. Është theksuar shpesh se është me rëndësi të sigurohet përkrahja e shtetit në financimin e kësaj forme të arsimit, pasi që standardi i ulët dhe shkalla e lartë e papunësisë shumë qytetarëve i pamundëson pagesën e studimeve. Supozohet se zhvillimi i arsimit të lartë në gjuhën shqipe, pjesëtarëve të kësaj bashkësie do t'iu mundësonte studim nga ana financiare, por edhe do t'iu mundësonte integrim më të lehtë në tregun e punës së Republikës së Serbisë dhe arritjen deri tek punësimi.

Shumica e theksojnë edhe rëndësinë e **investimit në zhvillim ekonomik**, duke theksuar se arsimit, vetë për vete nuk do ta nisë ekonominë. Ajo që është gjithsesi me rëndësi është se të anketuarit e theksojnë rëndësinë e rolit të shtetit në zhvillimin e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, jo vetëm përmes zhvillimit të arsimit të lartë por edhe përmes strategjisë përfshirëse që do të përmirësonte kushtet e jetesës së banorëve të kësaj pjese të Serbisë.

Kur bëhet fjalë për *qëndrimet* e të anketuarve, përveç të atyre të lartëpërmendura, pjesa më e madhe kishte të bënte me perceptcionin e marrëdhënieve ndëretnike, si dhe pozitës së vet në krahasim me kontekstin socio-ekonomik. Në zgjidhjen e parë, është me rëndësi të përmendet se shumica e të anketuarve thekson që në mes të bashkësive etnike (Shqiptarët, Romët dhe Serbët) nuk ekziston konflikt, por edhe se nuk ekziston as komunikim i zhvilluar posaçërisht. Ajo që është me rëndësi në kontekstin e studimit është se, pavarësisht nga orientimet personale ose distancës etnike të shprehur, respektivisht nga ajo nëse ndarjen në mes të bashkësive ia detyrojnë

karakteristikave "të lindura" të ndonjëres nga ato apo jo, gati se të gjithë të anketuarit mendojnë **se nevojitet shkallë më e lartë e integritit** dhe që zhvillimi i arsimit që do të përfshinte pjesëtarët e të gjitha bashkësive do të ishte hap i mirë në këtë drejtim. Kjo na tërheq vëmendjen, prapë, për rëndësinë të cilën të anketuarit ia kushtojnë politikave publike në kontekst të pasqyrës ekonomike dhe sociale të regjionit, si sot ashtu edhe në të ardhmen. Prandaj, duhet theksuar se perceptioni i të anketuarve lidhur me pozitën personale në kontekstin socio-ekonomik është kryesisht negativ; thënë në mënyrë të thjeshtë, të anketuarit perceptojnë Preshevën dhe Bujanocin si fusha në të cilat nuk ka shumë shpresë për zhvillim, dhe shumë të rinj theksojnë se si planifikojnë të largohen nga aty. Kjo, gjithashtu vërteton nevojën për zhvillim të arsimit të lartë- jo vetëm si mundësi direkte për arritjen e kualifikimit, por edhe të mundësisë më të madhe të punësimit dhe fitimit, por edhe jo më pak me rëndësi, zhvillimit të kuptimit të mundësive personale, si për të rinj ashtu edhe për pleqtë. Ky aspekt, prapë është me rëndësi, jo vetëm për shkak të përmirësimit të kushteve ekonomike dhe të përgjithshme të jetesës, por edhe për shkak të mundësive të qytetarëve të Preshevës dhe Bujanocit që plotësisht të marrin pjesë në jetën shoqërore dhe marrjen e vendimeve, jo vetëm në nivelin lokal por edhe në atë shtetëror dhe regjional.

IV Zgjidhjet e mundshme për zhvillimin e arsimit të lartë

Ajo që është me rëndësi të theksohet është se numri më i vogël i të anketuarve ka pasur koncepte komplete lidhur me zhvillimin e arsimit të lartë. Në tekstin e mëtejme së pari janë theksuar opsionet e theksuara dhe pastaj janë analizuar në kuadër të kategorive. Në fund, janë theksuar rekomandimet themelore. Natyrisht, aspektet e ndryshme të zgjidhjeve shpesh janë të përputhura në praktikë, dhe në analizë është e pamundur të ndahen plotësisht, e as nuk preferohet kjo. Klasifikimi i dhënë shërben vetëm si udhëzues dhe sqarim për strukturën dhe qasjen e analizës. Njëkohësisht, ajo është e rëndësishme për zhvillimin e zgjidhjeve praktike sepse e tërheq vëmendjen në faktin se çdo zgjidhje e ofruar ka anëte mira dhe të këqija, respektivisht se është e pmundur të identifikohet *një zgjidhje ideale*.

1. Shkallët e studimeve

Qëndrimi që mbretëron si në mes të institucioneve, ashtu edhe në mesin e të anketuarve, është se zhvillimi i arsimit të lartë në regjionin e Preshevës dhe Bujanocit duhet të jetë para së gjithash në nivelin e **studimeve të shkallës së parë (studimeve themelore)**. Në këtë kuptim, mbretërojnë studimet themelore akademike në krahasim me studimet profesionale, edhe pse është e mundur që kjo, përveç dallimit në "prestigj" që shkon në dobi të atyre akademike është edhe pasojë e faktit se shumë të anketuar nuk e dinë dallimin e vërtetë në mes të këtyre dy llojeve të studimeve. Megjithatë, është e sigurtë se studimet e shkallës së dytë dhe të tretë mungojnë plotësisht nga diskutimi.

Por, kjo nuk e ndryshon faktin se nga perspektiva e zhvillimit afatgjatë e arsimit, integritet shoqëror por edhe ekonomisë, e posaçërisht në kontekstin e reformës së arsimit në kaudër të procesit të Bolonjës, duhet menduar edhe për përsosmërinë e mëtejme të studentëve, para së gjithash në studimet e shkallës së dytë qoftë me zhvillimin afatgjatë në vetë komunat. Natyrisht kjo nuk do të thotë se patjetër duhet të jetë pjesë integrale e zhvillimit të arsimit të lartë në Jug të Serbisë në këtë moment por është me rëndësi të merret parasysh përsosmëria e nevojshme për perspektivën zhvillimore afatgjate.

2. Korniza institucionale

2a. Themeluesi

Ligji për arsimin e lartë parashikon që themeluesi i institucionit të shkollimit të lartë mund të jetë "Republika, personi fizik ose juridik, në pajtim me ligjin" (LpAL, Neni. 40). Në rastin e parë, vendimin për themelimin e bie Qeveria e Republikës së Serbisë. Gjatë hulumtimit, disa të anketuar e kanë përmendur edhe mundësinë e personit fizik ose juridik (institucionet e mundshme të shkollimit të lartë nga shtetet tjera) si themelues. Edhe pse kjo mundësi ekziston, është me rëndësi të përmendet se **zhvillimi i arsimit të lartë në kuadër të institucioneve, themelues i të cilave është Republika** bartë shumë përparësi. Dallimi kryesor në krahasim me themeluesin është mekanizmi i financimit. Institucioneve të shkollimit të lartë, themelues i të cilave është, Republika u siguron mjete për një varg çështjesh, duke përfshirë edhe shpenzimet materiale, mirëmbajtjen e rregullt dhe investive, rrogat e të punësuarve, si dhe një numër të caktuar të vendeve buxhetore për studentë. Vëllimi i financimit rregullohet me dispozita të posaçme. Çështja e financimit është me rëndësi të madhe për studentët e ardhshëm dhe prindërit e tyre. Në fakt, duke pasur parasysh shkallën e papunësisë dhe varfërisë në regjion, është gati se e sigurtë që një numër shumë i vogël i studentëve (ose prindërve të tyre) do të ishte në mundësi që të financojë studimet. Kjo është vërtetuar edhe në intervista. Për këtë arsye, zgjidhja e mëparshme e cila nënkupton zhvillimin e arsimit të lartë në kuadër të institucioneve themelues i të cilit është Republika ka përparësi të mëdha, pasi që mundëson ekzistimin e **vendeve buxhetore**, dhe në këtë kuptim e bën arsimin e lartë të mundshëm për studentët që nuk do të mund t'i paguanin ato.

Përveç numrit të mjaftueshëm të vendeve buxhetore për studentë, është me rëndësi edhe që sistemi i përkrahjes së **standardit studentor** të jetë i zhvilluar. Kjo nënkupton ekzistimin e **kredive studentore dhe stipendive** (që ekzistojnë në nivelin e Republikës, dhe tani me kushte të njejta do të ishin të mundshme edhe për studentët nga Presheva dhe Bujanoci), por edhe restorantet studentore (menzat), lehtësitë për transport (posaçërisht në mes të Bujanocit dhe Preshevës), etj. Çështja e përkrahjes financiare të studentëve është me rëndësi të madhe për sigurimin e mundësive të qasjes së njejtë ndaj arsimit të lartë, pavarësisht nga situata e posaçme materiale. Në këtë kuptim, do të ishte e domosdoshme të mendohet për fondet shtesë, stipenditë ose kreditë, që do të ishin të mundshme për studentët nga grupet e ndieshme dhe të marginalizuara, e jo vetëm atyre që tregojnë rezultate të shkëlqyeshme në shkollimin e

mëparshëm. Bashkëpunimi i pushteteve lokale dhe shtetërore është me rëndësi të posaçme në zhvillimin e përkrahjes ndaj studentëve.

2b. Lloji i institucionit

Ligji për arsimin e lartë (Neni 32.) parashikon që veprimtarinë e arsimit të lartë mund t'a ushtrojnë këto institucione: univerziteti, fakulteti respektivisht akademia artistike në kuadër të univerzitetit, akademia e shkencave profesionale, shkolla e lartë dhe shkolla e lartë e studimeve profesionale. Nga perspektiva e arsimit, lloji i institucionit në të cilën do të zhvillohet arsimi i lartë në regjion ka implikime të ndryshme. Univerziteti, përveç asaj që bart prestigjin më të lartë nënkupton edhe shkallën më të lartë të autonomisë, si në zhvillimin e planeve dhe programeve studimore dhe mësimore (kurikulumit), ashtu edhe në zgjedhjen e kuadrove. Themelimi i univerzitetit nënkupton vendimin e Qeverisë së Republikës së Serbisë për themelimin e univerzitetit, procesin e marrjes së lejes për punë, që nënkupton procesin e akreditimit dhe univerzitetit dhe programeve studimore, në harmoni me procedurën e shënuar me Ligjin për arsimin e lartë të shpjeguar në kreun V. Gjithashtu, Ligji për arsimin e lartë nënkupton që univerziteti duhet të ketë studime nga më së paku tri fusha shkencore edhe atë në të gjitha nivelet e studimeve akademike (pra, themelore, diplomike, akademike-master dhe studime të doktoraturës). Mund të konkludohet se momentalisht brenda kapaciteteve disponuese për zhvillim të strukturës së arsimit të lartë dhe kuadrove, haapja e univerzitetit nuk do të ishte thjesht e zbatueshme në afat të shkurtër ose të mesëm.

Opcioni tjetër institucional është fakulteti, ose më shumë fakultete. Hapja e fakultetit nënkupton që themeluesi i fakultetit duhet të jetë univerziteti ekzistues, duke pasur parasysh që Ligji për arsimin e lartë nga hyrja në fuqi nuk e lejon themelimin e fakultetit si institucion të arsimit të lartë të pavarur. Univerzitetet ekzistuese do të duhej të paraqitnin kërkesë për plotësimin e lejes për punë, si dhe të kalojnë procesin e akreditimit të fakulteteve të reja dhe programeve studimore, në harmoni me procedurën e rregulluar me Ligjin për arsimin e lartë dhe kreun e përshtuar V. Në kuptimin arsimor kjo zgjidhje do të kishte përparësi të caktuar, pasi që do të mundësonte koncentrim dhe dedikim më të madh të kuadros mësimdhënëse, që në atë rast do të ishte para së gjithash i angazhuar në atë institucion.

Institucioni i arsimit të lartë mund të themelojë njësi të arsimit të lartë jashtë selisë së vet, pa pronësi të personit juridik. Njësia e arsimit të lartë jashtë selisë së institucionit të arsimit të lartë në organizim dhe brenda administratës së fakultetit tanimë ekzistues në kuadër të univerzitetit ose në rast të studimeve ndërdisiplinore brenda administratës së univerzitetit. Vendimin për themelimin e njësisë së arsimit të lartë jashtë selisë së vet e bie institucioni i arsimit të lartë. Pastaj institucioni i arsimit të lartë paraqet kërkesën për plotësimin e lejes për punë e cila nënkupton akreditimin e programit sipas procedurës së rregulluar me Ligjin për arsimin e lartë.

Hapja e shkollave të larta, respektivisht shkollave të larta të studimeve profesionale, gjithashtu nënkupton procesin e dhënies së lejes për punë dhe procesin e akreditimit. Edhe pse themeluesi i

tyre nuk është e domosdoshme të jetë univerziteti, si institucione të pavarura të arsimit të lartë, ato iu nënshtrohen rregullores së njejtë, që do të thotë se hapja e tyre kërkon sigurimin e lejes për punë si dhe procesin e akreditimit. Nga ana tjetër, aspekti shoqëror (respektivisht kulturologjik) luan rol të madh në mënyrat me të cilat të anketuarit sillen rreth këtyre institucioneve. Këto institucione kryesisht konsiderohen si më të "ulëta" për nga statusi se sa fakulteti, kryesisht sepse shumica e të anketuarve e njohur me sistemin e arsimit, në kohën kur ato janë quajtur shkolla të "larta", në të vërtetë kanë pasur status më të ulët dhe sipas rregullës janë trajtuar si profesione më pak të çmuara dhe më pak të paguara. Edhe pse definicioni i tanishëm i shkollave të larta, respektivisht shkollave të larta të studimeve profesionale mundëson kalim në format e caktuara të përsosmërisë së mëtejme (studime specialistike), siç mund të shihet nga përshkrimi i sistemit të shkollimit, ajo edhe më tutje është e kufizuar.

Në kuptimin social, sigurisht që hapja e univerzitetit më së shumti do t'i impononte popullatës lokale, posaçërisht asaj të nacionalitetit shqiptar. Fakultetet si institucione janë si në vijim në listën e prestigjit: por duket sikur shumica e aktorëve lokal nuk e din dallimin e saktë në mes të fakultetit dhe njësive të arsimit të lartë pa status të personit juridik (që mund të shihet nga referimi i thjeshtë për projektin në Medvegjë si në "fakultet(e) përderisa, në të vërtetë është fjala për njësi të arsimit të lartë pa status të personit juridik). Është me rëndësi të përmendet që njësitë e arsimit të lartë pa status të personit juridik funksionojnë, financiarisht dhe administrativisht në kuadër të institucionit të arsimit të lartë dhe /ose fakulteteve në kuadër të së cilit janë themeluar.

Është me rëndësi të theksohet që procesi i hapjes së mundësisë së arsimit të lartë në Jug të Serbisë, pa marrë parasysh llojin e institucionit për të cilën palët e interesuara vendosin, paraqet proces të marrjes së lejes për punë dhe procesin e akreditimit sipas procedurave dhe standardeve të përcaktuara me Ligj dhe aktet ndërligjore. Të dy proceset kërkojnë përgatitje të kujdesshme të dokumentacionit të nevojshëm, që kërkon një periudhë të caktuar kohore.

3. Programet studimore

Sipas arsyeve respektivisht arsytive të cilat i kanë ofruar të anketuarit, programet studimore mund të ndahen në tri grupe: **të përgjithshme, të aplikueshme dhe zhvillimore.**

Në grupin e parë ("të përgjithshme") bëjnë pjesë programet studimore për të cilat të anketuarit mendojnë se ofrojnë spektër më të gjerë të punësimit. Këto janë juridiku, ekonomia, sistemi bankar respektivisht financat, menaxhmenti dhe deri diku informatika. Sigurisht sepse ofrojnë dituri më të përgjithshme dhe kompetenca, mund të vie më së lehti deri tek punësimi. Gjithashtu, këto janë profile që mund të "përdoren" nëse ekonomia në regjion fillon të zhvillohet, por edhe të përdorshme në pjesët tjera të vendit. Zhvillimi i suksesshëm i programit studimor në fushën e drejtësisë do të mund të ndihmonte shumëgjuhësinë në administratën shtetërore dhe të mundësojë komunikim më të lehtë gjatë proceseve juridike. Natyrisht, këtu duhet menjëherë të theksohet se, marrja me drejtësi në Republikën e Serbisë kërkon njohje të shkëlqyeshme të gjuhës serbe, përderisa marrja me drejtësi në ndonjë vend tjetër nënkupton njohje të

shkëlqyeshme të sistemit juridik të atij shteti. Në këtë kuptim, fokusi në studime të drejtësisë në ambient shumëgjuhësor do të nënkuptonte zhvillim të kompetencave në gjuhën serbe.

Grupi i dytë i programit studimor është quajtur "i aplikueshëm" sepse këto janë profesione, dituri dhe kompetenca që tregojnë se mund të aplikohen në mënyrë direkte respektivisht janë të përdorura në tregun e punës në Preshevë dhe Bujanoc. Në këtë grup bëjnë pjesë medicina, mësuesia por edhe programet studimore që do të mundësonin dituri ose përkthim në mes të gjuhës shqipe dhe serbe. Duke pasur parasysh se sistemi i mbrojtjes shëndetësore është i hapur, dhe që gati sigurtë standardi i shumicës së banorëve të Preshevës dhe Bujanocit nuk do të lejonte vizitë të mjekëve privat, kjo është diçka që luan rol të madh në marrëdhënie me dhe besimin në shtet dhe shërbime publike. Por, studimet e medicinës janë të shtrenjta kurse nënkuptojnë edhe ekzistimin e infrastrukturës (laboratore, pajisje) që momentalisht nuk ekzistojnë në Preshevë e as në Bujanoc. Model i mundshëm për shqyrtim në fakt është hapja e studimeve të medicinës, ku vitin e parë studentët e ndjekin në Preshevë ose Bujanoc dhe pastaj studimet i vazhdojnë në ndonjërin nga qendrat univerzitare të Serbisë. Edhe pse një zgjidhje e tillë do të ishte e mirë nga pikëpamja e integritit në sistemin arsimor dhe profesional të Republikës së Serbisë, ajo do të kërkonte zgjidhje sistematike të problemeve lidhur me pamundësinë e studentëve që të studiojnë në vende larg Preshevës dhe Bujanocit— para së gjithash për shkak të pamundësive financiare, por edhe ato lidhur me ndjenjën e sigurisë ose pasigurisë të cilën shumica e pjesëtarëve të bashkësisë shqiptare e ndërlidhin me idenë e të studiuarit në qytete ku paraqesin pakicat.

Profilat e mësuesisë kryesisht janë bazuar në perceptimin e mungesës së kuadrove të kualifikuara mësimore – para së gjithash të atyre që mësimin do t'a mbanin në gjuhën shqipe, por edhe arsimtarëve të kualifikuar të gjuhës serbe (gati se të gjithë të anketuarit, pavarësisht nga përkatësia etnike, kanë shprehur mungesë të kuadrove të kualifikuara për mësim të gjuhës dhe letërsisë serbe që e vërtetojnë edhe të dhënat e SHNP). Nuk është e nevojshme që të theksohet se ky fakt e rëndon në mënyrë shtesë mundësinë e komunikimit ndëretnik për të cilin parakusht është që të paktën një grup personash rrjedhshëm të mbizotërojë me gjuhën e tjetrës. Në këtë kuptim do të ishte mirë të zhvillohen edhe programe për arsimimin e arsimtarëve në gjuhën rome, pastaj edhe për lëndë siç është kultura rome, etj.

Vetë rëndësia e kompetencave të arsimtarëve, natyrisht është shumë e çmueshme. Prandaj, zhvillimi i programeve studimore për mësues (dhe edukatorë) është i rëndësishëm jo vetëm në kontekstin e "plotësimit" të vendeve të punës, por edhe në kuptimin e zhvillimit të kompetencave që do të ndihmojë zhvillimin e suksesshëm të gjeneratave të reja. Gjithashtu duhet patur kujdes për mundësinë e ngopjes së shpejtë të tregut të punës, respektivisht plotësimin e vendeve ekzistuese të punës, siç ishte rasti në Mal të Zi.

Kur bëhet fjalë për mësimin ose përkthimin në mes të gjuhës shqipe dhe serbe, është e qartë se ekziston nevojë e madhe për njerëz të arsimuar që mund t'i përdorin të dyja gjuhët. , Edhe pse të dyja profilet janë të rëndësishme dhe sigurisht do të kontribuonin jo vetëm kompetencave gjuhësore por edhe zhvillimit të identitetit të bashkësisë, duhet ditur që njohja e të dyja gjuhëve

në këtë regjion para së gjithash, të paktën deri më tani ka qenë e perceptuar si mjet (për rritjen e efikasitetit të administratës lokale dhe shërbimeve tjera publike, më së shpeshti) e jo vetëm si qëllim vetë për vete. Në këtë kuptim, integrimi i mësimit në të dy gjuhët në kuadër të programeve tjera studimore do të paraqitte hapin e parë të dobishëm; përderisa studimet e orientuara në mënyrë specifike në kompetenca në të dyja gjuhët mund të zhvillohen paralelisht por në këtë kuptim është shumë me rëndësi të sigurohet punësim i studentëve të diplomuar në sfera të ndryshme.

Më në fund, grupi i fundit i programeve studimore është quajtur **zhvillimor**. Në këtë grup bëjnë pjesë tekniku, makineria, ndërtimtaria, bujqësia, teknologjia (teknologjia ushqimore), hotelieria dhe turizmi. Këto janë profile që janë identifikuar si të tilla që kanë potencial për të zhvilluar ekonominë e rajonit, duke u koncentruar qoftë në kompetenca gjenerike (teknike, makineri, ndërtimtari) qoftë në zhvillim të potencialeve që janë identifikuar si përparësi diferenciale të Preshevës dhe Bujanocit (turizmi, hotelieria, tregëtia, teknologjia ushqimore). Profilet e dhëna janë gjithsesi shumë të rëndësishme, sepse edhe vetë të anketuarit i identifikojnë si motor për gjenerim të zhvillimit ekonomik të regjionit, që do të mund të kontribuonte në rritjen punësimit dhe standardit të përgjithshëm. Por, ato kërkojnë planifikim të kujdesshëm me partneritet të fortë me tregëtinë: të gjitha programet e përmendura kërkojnë praktikë dhe supozohet se duhet të cojnë drejt diturive të aplikueshme. Pra, duhet të zhvillohen profile të tilla, por në partneritet me tregëtinë e regjionit, si me ndërmarrjet e mëdha ashtu edhe ato të vogla dhe të mesme.

Konkludimi që mund të bëhet është se zgjidhja e fushave në të cilat do të zhvillohen programet studimore në Preshevë dhe Bujanoc duhe të udhëhiqet me dëshirat e studentëve të ardhshëm por edhe mundësitë e punësimit që ofrojnë profesionet e caktuara, në kuptim të deficitit në tregun e punës, si dhe mundësinë që të fillojnë zhvillimin ekonomik. Në këtë kuptim, si më të rëndësishmet janë theksuar drejtësia, ekonomia, mësuesia, profili teknologjik (mësimor) ose maqineria. Në mënyrë shtesë, është treguar që gati se në të gjitha fushat ekziston nevoja për kuadro të kualifikuar që zotëron me gjuhën serbe dhe shqipe, dhe sipas mundësisë, me gjuhën angleze ose gjuhë tjetër të huaj.

4. Grupi qëllimor

4a. Grupi qëllimor

Është shumë me rëndësi që të kihet parasysh se perceptcioni mbizotërues social në mes të të anketuarve, gjatë (posaçërisht në fazat fillestare) hulumtimit në terren, ka qenë se projekti i hapjes së institucionit të arsimit të lartë në regjionin e Preshevës dhe Bujanocit është i dedikuar para së gjithash për pjesëtarët e bashkësisë shqiptare. Në kuptimin analitik, natyrsht, është e qartë se ekzistenca e programit arsimor që është i dedikuar kryesisht për pejsëtarët e disa grupeve, është e qartë se ekzistimi i programit arsimor që iu është dedikuar kryesisht disa grupeve nuk i kontribuon kohezionit shoqëror e as integritet. Gjithsesi, arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc duhet t'iu dedikohet të gjithëve, pavarësisht nga përkatësia etnike (ose tjetër) ose duhet

përkujdesur që të jetë edhe i qasshëm. Por, sfidën kryesore në këtë kuptim e paraqet organizata e mësimit, respektivisht gjuha, kuadroja mësimore dhe tekstet.

4b. Gjuha e mësimit

Kur bëhet fjalë për gjuhën në të cilën mbahet mësimi, nëse e pranojmë argumentimin e shprehur kundër organizimit të mësimit qoftë vetëm në gjuhën shqipe qoftë vetëm në gjuhën serbe, mbetet shqyrtimi i zgjidhjeve të mundshme për mësim në të dyja gjuhët (duke përfshirë eventualisht edhe gjuhën rome si gjuhë të tretë). Kryesisht propozohen dy zgjidhje: njëra nënkupton departamente të ndara "serbe" dhe "shqiptare", kurse tjetra përkthim simultan nga njëra gjuhë në tjetrën.

Zgjidhja e parë nënkupton që mësimi për studentë të zhvillohet paralelisht në gjuhën serbe dhe shqipe dhe që studentët të kenë ndonjë ligjëratë ose aktivitet bashkë. Edhe pse kjo është preferencë e shumicës së të anketuarve, dhe mundëson përcjellje më të thjeshtë të mësimit për studentë, organizimi i një mësimi të tillë nuk është pa probleme. Në fakt, kompetencat gjuhësore të profesorëve të univerzitetit tregojnë se në këtë rast një grup i ligjëruesve do të mbanin mësim në gjuhën shqipe, kurse tjetri në gjuhën serbe. Kjo sigurisht do të shkaktonte disa probleme lidhur me koordinimin e programeve studimore, respektivisht përmbajtjeve mësimore, si dhe metoda e të pyeturit/notimi.

Në kuadër të kësaj zgjidhje, disa të anketuar kanë propozuar që orët "e përbashkëta" për studentë nga të dyja bashkësitë të jenë në gjuhën angleze. Në kuptimin arsimor, kjo do të ishte zgjidhje e shkëlqyeshme, sepse studentët do t'i bënte të aftë të përcillnin mësimin, përveç në gjuhën amtare edhe në atë angleze. Por, kjo paraqet kërkesa edhe më të mëdha organizative, duke pasur parasysh se paraqet edhe aftësi që të mbahen ligjëratat në gjuhën angleze si kompetencë për ligjërues.

Por, ajo që është gjithsesi me rëndësi, dhe është reflektuar edhe në përgjigjet e të anketuarve, është se zhvillimi i arsimit të lartë do të kërkonte, dhe qoftë edhe në mënyrë fakultative, mësim të gjuhës tjetër të bashkësisë. Kur bëhet fjalë për gjuhën serbe, njohja e tyre, qoftë edhe në nivelin e komunikimit formal, është kusht i domosdoshëm i integritit të banorëve të nacionalitetit shqiptar në kornizë të gjerë të Republikës së Serbisë. Nga ana tjetër, banorët e nacionalitetit serb gati se kurrë nuk flasin shqip. Është e sigurtë se njohja e të dy gjuhëve do të kishte pasoja shumë pozitive në interakcionin dhe komunikimin e pjesëtarëve të të gjitha bashkësive; arsimit të lartë është vend ku kjo mund të shëndrrohet në praktikë. Është e mundur që mësimi i gjuhës tjetër të bëhet jo vetëm fakultativ por edhe i obligueshëm; njëkohësisht, është e mundur të zhvillohen grupe të përbashkëta "grupe për të mësuar" të folësve të gjuhës serbe dhe shqipe, ku do të mund të ndihmoheshin në mes vete në mësimin e gjuhës tjetër (këto grupe joformale janë praktikë në shumë univerzitete në shtete të huaja). Në programe të caktuara studimore, siç u përmend, do të mund të përfshihet edhe mësimi i gjuhës rome. Në kombinim me

mësimin e gjuhës angleze, ky model do t'i mundësonte studentëve që pas studimeve të prfunduara të zotërojnë me tri gjuhët, që gjithsesi do të paraqitte përparësi me rastin e punësimit.

Zgjidhja që nënkupton përkthim simultan nga njëra gjuhë në tjetrën, edhe pse mund të jetë e përkohshme, paraqet shumë probleme. Problemi i parë më i madh është kualiteti i përkthimit. Përkthimi simultan kërkon jo vetëm njohje të shkëlqyeshme të të dyja gjuhëve- si të asaj nga e cila përkthehet-ashtu edhe atë në të cilën përkthehet- por edhe njohuri me terminologjinë profesionale dhe literaturën. Siç është treguar në Medvegjë, gjetja e kuadrove që është mjaft i aftësuar për këtë detyrë është shumë e vështirë, posaçërisht duke pasur parasysh që përkthimi kualitativ simultan kërkon punë të njëkohshme të më së paku dy përkthyesve, pavarësisht nga ajo se në cilën gjuhë mbahet mësimi. Përkthimi jokualitativ në afat të gjatë mund të ndikojë negativisht në motivimin e studentëve për përcjelljen e mësimit. Nëse mësimi do të zhvillohej në dy gjuhë, përqindja e caktuar e ligjëratarave të përbashkëta (ku një pjesë e studentëve do të dëgjonte përkthim simultan), duke përfshirë edhe ligjëruesit mysafirë, duhet të shqyrtohet. Në kombinim me mësimin e gjuhës tjetër në kuadër të programit studimor, kjo në fund do të mund të sillte deri tek ajo që shumica e studentëve janë të aftë të dëgjojnë, të paktën disa ligjërata në të dyja gjuhët.

Pra ajo që është me rëndësi është që çdo bashkësi t'i sigurohet mundësia të dëgjojë të paktën një pjesë të mësimit në gjuhën amtare, por edhe të zhvillojë tek studentët kompetenca në gjuhët e bashkësive tjera, por edhe në gjuhën angleze. Kjo mund të arrihet përmes organizimit të aktiviteteve të përbashkëta- si atyre akademike (p.sh. ligjërimit të profesorëve mysafirë, "grupeve për mësim"), ashtu edhe të tjerëve, (shoqatat sportive, klubeve, organizatave studentore, etj).

4c. Kuadrot mësimore

Gjuha në të cilën realizohet mësimi përcakton edhe nevojën për kuadro mësimore. Në këtë rast, kjo do të thotë se do të ishte i nevojshëm angazhimi i kuadros së kualifikuar edhe për mësim në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Zgjidhja më e mundshme është që ligjëruesit gjuha amtare e të cilëve është gjuha serbe të vijnë nga institucioni (univerziteti respektivisht fakulteti) që e organizon programin studimor. Por është shumë me rëndësi të sigurohemi se kuadrot mësimore kanë mjaft kohë që t'ia kushtojnë këtij programi studimor, duke përfshirë përgatitjen e mësimit, komunikimin dhe konsultimet me studentët. Thjeshtë "kopjimi" i planeve mësimore len përshtypje të keqe dhe ndikon në mënyrë demotivuese tek studentët, e të mos flasim për dedikimin e pamjaftueshëm të ligjëruesve. Në këtë kuptim, do të ishte shumë e udhës që të hapeshin vende të reja të punës në institucionet ekzistuese. Në këtë kontekst është posaçërisht me rëndësi roli i asistentit, respektivisht bashkëpunëtorit në mësim. Studentët e doktoratit, sipas rregullave persona të rinj, shpesh kanë motivim më të madh profesional për punë me grupe të reja të studentëve. Nga njëra anë, kjo për ata do të mund të paraqitte lehtësi financiare gjatë studimeve të doktoratit, kurse nga ana tjetër gjithsesi do t'i kontribuonte interakcionit dhe komunikimit në mes të studentëve dhe kuadrove mësimore. Shumica e të anketuarve supozon se

njëfarë lloji i kuadrove të kualifikuara ekziston në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Ky, natyrisht është opcioni më i lehtë dhe më i volitshëm, por duhet patur kujdes për atë se mësimi në nivelin univerzitar prapë nënkupton të paktën posedimin e doktoratit. Ajo që është e mundur, nga ana tjetër është të angazhohen njerëz të rinj nga Presheva dhe Bujanoci si bashkëpunëtor në mësimdhënie. Në rastin ideal, këta do të ishin njerëz të cilët tanimë janë duke bërë master ose studime të doktoraturës (qoftë në Serbi, në Kosovë, Maqedoni, por edhe në Shqipëri), por është e mundur edhe që studentëve të rinj të diplomuar nga Presheva dhe Bujanoci t'i ofrohen stipendi për studime postdiplomike të bazuara në pozitën e tyre të bashkëpunëtorëve në mësim, në kuadër të programeve studimore në Preshevë ose Bujanoc. Kjo është praktika që është model i zakonshëm i financimit të studimeve postdiplomike, si në shtete tjera kështu (së fundi) edhe në disa univerzitete në Serbi, dhe njëkohësisht përmbush dy funksione: nga njëra anë, mundëson ekzistimin e kuadrit të ri të kualifikuar për mbajtjen e mësimit, kurse nga ana tjetër zhvillon kapitalin njerëzor në regjionin e Preshevës dhe Bujanocit, pasi që siguron fuqi punëtore me kualitet të lartë. Bashkëpunëtorët në mësim do të mund të bëhen arsimtarët me kohë të plotë të punës pas mbarimit të studimeve të doktoraturës.

Sa i përket kuadrove tjera të mundshme që flasin gjuhën shqipe, të anketuarit kryesisht kanë propozuar angazhimin e ligjëruesve të përhershëm ose mysafirë nga Univerziteti i Evropës Juglindore në Tetovë, Univerziteti në Tiranë ose Univerziteti në Prishtinë; ekzistojnë indikacione që disa ligjërues, (posaçërisht në Tetovë) kanë kompetenca për mbajtjen e mësimit si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze, kështu që ky opcion definitivisht meriton hulumtim të mëtejshëm. Ajo që është gjithashtu opcion është që të shikohet se a kanë këto institucione evidencë të studentëve që doktoratet i kanë arritur në shtete tjera. Trendet në arsimim tregojnë se të rinj të tillë do të ketë gjithnjë më shumë, por nuk do të mund të gjejnë punë menjëherë. Në këtë kuptim, pozita e docentit në ndonjërin nga programet studimore në Preshevë dhe Bujanoc do të mund të paraqitet për ata fillim të mirë dhe "hap përpara" për karrierën në të ardhmen.

4d. Tekstet

E lidhur ngushtë me çështjen e gjuhës dhe kuadrove, natyrisht është edhe çështja e teksteve dhe mjeteve tjera mësimore. Kjo është posaçërisht e shprehur në perceptcionet e të anketuarve që zakonisht supozojnë se çdo profesor e ka librin e "vet".

Edhe pse këto zgjidhje vijnë në konsiderim në perspektivë afatshkurtër, në atë afatgjatë ato paraqesin problem serioz të paralelizmit, respektivisht mungesës së koherencës së programeve mësimore: nëse një grup i studentëve mëson në një gjuhë, me një palë libra, ligjërues dhe një sistem të notimit, kurse grupi tjetër me të tjerë, është dilemë shumë e madhe në çfarë lidhje janë këto dy grupe, respektivisht pse kjo do të quhej një program studimor. Pra, duhet me kohë të synohet për bashkimin sa më të madh të silabusit dhe kurrikulumit, dhe, siç është theksuar edhe me aktivitete/ligjërata të përbashkëta, respektivisht kompetencat e studentëve në të dyja gjuhët.

Në këtë proces, është e domosdoshme të merren parasysh kriteriumet e kualitetit: studentët nuk përfitojnë shumë duke shfrytëzuar libra të shkruara dhe të përkthyer në mënyrë jokualitative. Shikuar në përgjithësi, **sigurimi i kualitetit** në kuadër të organizimit të programeve studimore, kurikulimit dhe procesit mësimor është me rëndësi të posaçme për suksesin e kësaj iniciative.

5. Çështjet infrastrukturore

5a. Lokacioni

Zgjidhje ideale do të ishte të zhvillohet arsimi i lartë në të dy komunat- Preshevë dhe Bujanoc. Kjo, jo vetëm që do t'i paraprinte konfliktit të mundshëm lidhur me lokacionin, por edhe do t'i kontribuonte zhvillimit ekonomik më të barabartë. Por, edhe nëse kjo nuk do të ndodhë, largësia në mes të këtyre dy komunave nuk është e pakalueshme, kështu që edhe për studentët që jetojnë në njërin komunë do të ishte e lehtë të studiojnë në komunën tjetër. Gjithsesi, siç është theksuar në kontekst të standardit studentor, kjo do të nënkuptonte zhvillim të linjave efikase të transportit në mes të dy qyteteve, duke iu përshtatur nevojave dhe buxhetit të studentëve.

5b. Ndërtesa

Në lidhje të ngushtë me lokacionin është edhe ndërtesa në të cilën do të zhvillohet mësimi në kuadër të programeve të ardhshme studentore. Ngjashëm me qëndrimet lidhur me vendin, banorët kanë prirje të theksojnë përparësitë e objekteve lokale. Në kuptimin shoqëror dhe integruës, gjithsesi më së miri do të ishte të zhvillohej arsimi i lartë edhe në Preshevë edhe në Bujanoc dhe kështu të angazhohen të gjitha kapacitetet lokale: ato të Bujanocit për shembull do të mund të shfrytëzohen për profile që nënkuptojnë numër më të vogël të studentëve, siç janë mësuësia ose hotelieria dhe turizmi, përderisa kapacitetet e Preshevës do të mund të shërbenin për zhvillimin e programeve të mëdha studimore lidhur me sistemin bankar, menaxhment, teknologji, makineri, bujqësi dhe eventualisht juridik dhe ekonomi. Ajo që është treguar në hulumtimin në terren është se për këtë gjithsesi ekziston vullnet i mirë në mes të popullatës. Pra, realizimi i projektit do të varet para së gjithash nga planifikimi i mirë dhe koordinimi në mes të realizatorëve dhe bashkësive lokale.

5c. Kapacitetet administrative dhe informative

Kur flitet për kapacitetet administrative dhe informative, është me rëndësi të sigurohet ekzistenca e administratës funksionale dhe të disponueshme, posaçërisht të shërbimit studentor, puna e të cilëve duhet të jetë në gjuhët e bashkësive që e ndjekin shkollimin e lartë. Shërbimet studentore do të duhej të mundësonin jo vetëm përkrahje administrative por edhe përkrahje këshillimore për studentët, posaçërisht në rast të ballafaqimit me vështirësi (financiare ose të ndonjë lloji tjetër) gjatë studimeve.

Gjithashtu, është me rëndësi të zhvillohet sistem i mirë administrativ që do të jetë në shërbim të studentëve, por edhe personave tjerë që janë të interesuar (p.sh. studentëve potencial, prindërve

të tyre, etj.). Por këtu është shumë me rëndësi përkujdesja për teknologjinë kompjuterike, ku studentët do të kishin qasje falas në kompjuterë, si dhe trajnim për përdorimin e kompjuterëve dhe internetit, posaçërisht në kontekst të aktiviteteve akademike.

Konkludimi që mund të bëhet është se zhvillimi i arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc duhet të ketë parasysh zhvillimin e barabartë të regjionit, natyrisht, duke respektuar specifikat e çdo komune. Vëmendje të posaçme duhet kushtuar kapaciteteve infrastrukturore, jo vetëm në pikëpamje të lokacionit (objektit) për shkollim të lartë por edhe në kuptimin e transportit dhe sigurimit të funksionimit efikas të përkrahjes administrative dhe informative. Faktor inkurajues është që bashkësitë lokale duken të gatshme për të ofruar përkrahje dhe bashkëpunim në këtë proces.

IV Konkludimet dhe rekomandimet preliminare

Konkludimi

Siç mund të konkludohet nga parathënia, zhvillimi i arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc paraqet një sfidë të vërtetë: specificiteti i regjionit, dëshirat e ndryshme të palëve të interesuara, por edhe konsensusi rreth nevojës së madhe për zhvillim të arsimit të lartë në këto fusha, që rezulton me shpresa të mëdha, përbëjnë konkludime të shpejta dhe konkludime ekskluzive, jo vetëm të padëshiruara por edhe të pamundura. Në këtë kuptim, qëllimi i këtij studimi nuk ka qenë të identifikojë një zgjidhje të mirë duke përjashtuar të gjitha të tjerat, por të shqyrtojë përparësitë dhe mangësitë e zgjidhjeve të mundshme, si në krahasim me mundësitë objektive dhe kufizimet, ashtu edhe në dëshira të atyre që do të jenë të integruar në këtë proces në mënyrë direkte ose indirekte. Në përfundim, prandaj janë ofruar rekomandime të përgjithshme, pastaj janë propozuar disa hapa, respektivisht mënyra në të cilat ato mund të realizohen.

1. Procesi i zhvillimit të arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc po fillon. Ky studim i rastit ka pasur për qëllim të përshkruaj drejtimit e mundshme themelore të zhvillimit, por edhe pjesën më të madhe të planifikimit të mëtejme do të varet nga palët e interesuara- **Ministria e arsimit, Trupi koordinues, bashkësitë akademike, pushtetet lokale, përfaqësuesit e bashkësive lokale, shoqërisë civile etj.** Bashkëpunimi i të gjitha palëve të interesuara në proces do të jetë me rëndësi të posaçme për suksesin e tij. Në këtë kuptim mund të propozohet që:

-Grupet e interesuara të formojnë grupin punues (në kuadër të Ministrisë së arsimit ose Trupit koordinues) detyra kryesore e të cilit do të ishte planifikimi i mëtejme dhe zbatimi në vepër i zhvillimit të arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc. Përveç të lartëpërmendurve (Ministrisë së arsimit, Trupit koordinues, bashkësisë akademike, pushteteve lokale, përfaqësuesve të

bashkësive lokale, shoqërisë civile) do të ishte mirë që në atë trup të marrin pjesë edhe ekspertë ndërkombëtar dhe vendor nga fusha e zhvillimit të arsimit të lartë;

-Të sigurohet dialog i përhershëm në mes të grupit punues, trupave që e përbëjnë dhe anëtarëve të bashkësisë shqiptare dhe serbe në nivelin lokal (përmes takimeve, forumeve dhe diskutimeve). Ky hap është i rëndësishëm për shkak të sigurimit të pjesëmarrjes së vazhdueshme dhe aktiviteteve të të gjitha anëve të interesuara në proces.

2. Procesi i zhvillimit të arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc duhet të zhvillohet në **kornizë institucionale të Republikës së Serbisë**. Kjo kornizë ka shumë përparësi: përveç asaj që mundëson integrim më të shpejtë dhe më të lehtë, si në shoqëri ashtu edhe në tregun e punës, ai supozon mundësi më të mëdha ndaj studentëve gjatë procesit të arritjes së arsimit të lartë, dhe në këtë mënyrë e bën më të qasshëm. Në këtë kuptim mund të rekomandohet që:

-Zhvillimi i arsimit të lartë në territorin e Preshevës dhe Bujanocit duhet të jetë në kuadër të ndonjë institucioni ekzistues të arsimit të lartë, themelues i të cilit është Republika e Serbisë. Përveç Univerzitetit në Nish, janë edhe Univerziteti shtetëror në Novi Pazar, Univerziteti në Kragujevc por edhe ata në Beograd ose Novi Sad, respektivisht fakultetet e këtyre univerziteteve;

-Në këtë proces duhet patur kujdes për kërkesat juridike respektivisht ligjore dhe kufizimet. Edhe pse zhvillimi i arsimit të lartë në kuadër të institucionit ekzistues deri diku e shkurton procedurën e hapjes, ai në kuadër të legjislacionit ekzistues gjithsesi nënkupton si sigurimin e lejes për punë, ashtu edhe procesin e akreditimit. Në këtë kuptim, do të ishte e domosdoshme të integrohet ekspertiza juridike dhe ajo e bashkësisë akademike (posaçërisht përvojat lidhur me akreditimin) me qëllim të arritjes deri tek zgjidhja më e thjeshtë për zbatimin e iniciativave konkrete, kur ato të zhvillohen.

3. Zhvillimi i arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc duhet të jetë i **qëndrueshëm**; programet studimore të zhvilluara në këto komuna duhet të përmbushin nevojat e tregut, por edhe të kenë aftësi të inicimit të zhvillimit ekonomik. Kjo do të thotë se zgjidhja e fushës nga e cila do të zbatohen programet studimore në Preshevë dhe Bujanoc nuk duhet të bazohet vetëm në dëshirat e shprehura të shfrytëzuesve potencial , por edhe në mundësitë objektive të "ngopjes" së tregut edhe përveç informimit konstant lidhur me nevojat, të zhvillohet mësim i përrjetshëm dhe forma të tjera të arsimit në mënyrë që do të parandalojë këtë mundësi. Në këtë kuptim mund të rekomandohet:

-Zhvillim i programeve studimore për mësues si dhe arsimtarë të gjuhës serbe, shqipe dhe rome. Profesionet e përmendura janë treguar si deficitare në regjion, dhe janë me rëndësi të madhe jo vetëm për zhvillimin e kompetencave të përgjithshme por edhe atyre gjuhësore që janë parakusht i domosdoshëm për komunikim të suksesshëm ndëretnik. Zhvillimi i programeve studimore për mësues do të mund të zhvillohej në bashkëpunim me Fakultetin e mësuesisë në Vranjë, të Univerzitetit të Nishit, që është i vendosur relativisht afër Bujanocit.

Zhvillimi i programeve studimore për arsimtarë të gjuhës do të nënkuptonte bashkëpunim me ndonjërin nga institucionet që kanë programe studimore, nga, njëra anë gjuha shqipe dhe naga ana tjetër nga gjuha dhe letërsia serbe. Së pari është rasti nga univerziteti në Beograd, e më tej edhe me gati çdo univerzitet në Serbi. Kur bëhet fjalë për gjuhën dhe letërsinë shqipe, është e mundur të zhvillohen edhe programe të përbashkëta studimore me institucionet në ndonjërin nga shtetet fqinje. Ajo që është me rëndësi është se, edhe pse diploma nga fusha e gjuhës dhe letërsisë në Serbi jep titullin profesor respektivisht arsimtarë të asaj gjuhe, me trajnim të shtuar dhe kushte plotësuese do të mund të punësoheshin edhe në administratë publike dhe shërbime në të cilat njohja e më shumë gjuhëve paraqet përparësi të madhe.

-Zhvillimi i programeve studimore nga fusha e drejtësisë, ekonomisë dhe informatikës, respektivisht atyre fushave që zhvillojnë kompetenca gjenerike të cilat pastaj mund të aplikohen në fushë të gjerë të profesioneve. Nevojë e posaçme është theksuar për juristë të cilët flasin edhe gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe, dhe përveç në gjyqësi do të mund të punonin edhe në administratë shtetërore, respektivisht në administratë. Ngjashëm me këtë, fushat si ekonomia (posaçërisht drejtimet si sistemi bankar dhe menaxhimi) dhe informatika ofrojnë kompetenca që potencialisht mund të aplikohen në vende të ndryshme, prej institucioneve financiare deri tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Dy programet e fundit kanë përparësi aq më tepër sepse janë relativisht "univerzale" dhe materiali mësimor nuk duhet t'iu përshtatet kushtimisht ambientit, siç është rasti me drejtësinë.

-Zhvillimi i programeve studimore që do të mund të ndihmonin zhvillimin e potencialeve ekzistuese në Bujanoc dhe Preshevë, siç do të ishin teknologjia ushqimore, makineria, turizmi-hotelieria, etj. Ajo që është me rëndësi të merret parasysh është se zhvillimi i programeve të tilla mund të zhvillohet vetëm në partneritet të fortë me sektorin ekonomik: të zhvillohen programe studimore nga fusha e dedikuar ekonomisë para strategjisë së zhvillimit të saj nuk do të jepte rezultate të mira për punësim. Por, partneriteti i fortë me ekonominë do të ishte motivim i mirë si për sektorin arsimor ashtu edhe atë ekonomik; këto programe mund të zhvillohen në kuadër të strategjisë së zhvillimit të komunave të Preshevës dhe Bujanocit.

-Zhvillimi i kuadrit arsimor që do të mund të bartë ngarkesën e programeve të reja arsimore.

4. Zhvillimi i arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc duhet të jetë **integruar**, në kuptim të zhvillimit të diturisë dhe kompetencave të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive. Kjo nënkupton zhvillimin e programeve studimore si në gjuhën serbe ashtu edhe në atë shqipe kurse do të ishte ideale edhe në gjuhën rome. Por zbatimi paralel i mësimit në më shumë gjuhë nuk është zgjidhje vetë për vetë. Pra është me rëndësi të zhvillohen aktivitete të përbashkëta, nga të cilat disa mund të jenë edhe në gjuhën angleze, për të mundësuar socializim dhe komunikim të pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme. Këto aktivitete duhet të shkojnë drejt zhvillimit të diturisë së gjuhës së dytë (dhe të tretë) që fliten në Bujanoc dhe Preshevë; ajo që është gjithsesi me rëndësi është që të sigurohet që pjesëtarët e të gjitha bashkësive të arrijnë dituri, para së gjithash të gjuhës shqipe por edhe asaj rome, që përveç lehtësimit të komunikimit të

ndërsjellë duhet të rrisë shanset për punësim. Përveç kësaj, është me rëndësi të zhvillohet edhe dituria e gjuhës angleze përmes aktiviteteve të mundshme të përbashkëta akademike dhe joakademike. Ajo që është me rëndësi të tejkalohet, në të vërtetë është zhvillimi i programeve "paralele" në secilën nga gjuhët: arsimit i lartë në Preshevë dhe Bujanoc duhet të jetë sa më i integruar, në kuptim të zhvillimit të kulturës së përbashkët dhe vetëdijes për përkatësinë ndaj shoqërisë së njejtë tek studentët. Prandaj, integrimi nuk duhet të nënkuptojë vetëm çiltërsi për pjesëtarët e të gjitha bashkësive por edhe mundësi që të gjithë bashkë të marrin pjesë në marrjen e vendimeve dhe ndërtimin e ardhmërisë së Preshevës dhe Bujanocit. Në këtë kuptim është e mundur të zhvillohen:

-Programe studimore që përfshijnë mësim në gjuhën serbe, shqipe dhe në disa raste edhe në gjuhën rome. Duhet patur kujdes për sigurimin e parakushteve ligjore për një lloj të këtillë të mësimit, në kuadër të statutit të institucionit që është bartës. Kurikulumi duhet të synojë drejt bashkimit sa më të madh, respektivisht ngjashmërive për të mos ardhur deri tek zhvillimi i programeve "paralele" që do të kenë pak pika të përbashkëta. Kjo nënkupton zhvillim të përbashkët të planeve dhe programeve mësimore në të gjitha gjuhët e mësimit, që do të duhej të zhvillohej përmes bisedës së personelit arsimor.

-Resurset njerëzore në pikëpamje të arsimtarëve, bashkëpunëtorëve në arsim dhe personelit administrativ. Kjo është posaçërisht me rëndësi për shkak të stërngarkesës së kuadrit ekzistues arsimor. Në variantën ideale, personeli do të duhej të flasë qoftë edhe dy nga tri gjuhët e bashkësive në Preshevë dhe Bujanoc. Gjatë hulumtimit janë paraqitur indicione që resurset e tilla ekzistojnë në regjion , dhe do të ishte mirë që kjo të hulumtohet. Në opcionin në të cilin personeli arsimor flet vetëm një nga gjuhët e arsimit, personat që japin mësim në gjuhën serbe mund të angazhohen përmes institucioneve ekzistuese të arsimit të lartë në Serbi (me mundësi të zgjerimit të kapaciteteve të tyre), kurse personat që japin mësim në gjuhën shqipe përmes institucioneve të arsimit të lartë me mësim në gjuhën shqipe nga vendet fqinje (si marrëveshja të cilën Univerziteti i Malit të Zi e ka me univerzitetet në Tiranë dhe në Shkodër 1). Është e mundur që personat që japin mësim në gjuhën rome mund të kontaktohen me ndihmën e organizatave lokale ose ndërkombëtare të cilat merren me të drejtat e Romëve. Ajo që është me rëndësi në këtë proces, përveç përkujdesjes për rregullat juridike lidhur me ligjëruesit musafir nga institucionet e arsimit të lartë në vend dhe jashtë vendit, është që të zhvillohet kuadër i mirë bashkëpunëtorësh, që do të mund të jetë nga radhët e doktorantëve preshevar ose bujanovcas në studime në Serbi ose vende fqinje. Bashkëpunëtorët në mësimdhënie sigurojnë kontakte të përhershme me studentët dhe iu ndihmojnë në procesin e studimeve, kështu që në kuptimin e caktuar janë edhe më të rëndësishëm se profesorët dhe arsimtarët. Nga ana tjetër, duke përkrahur bashkëpunëtorët në mësimdhënie do të mund të sigurohej kuadër i ri mësimor i përhershëm.

- Mësimi i gjuhës së dytë ose të tretë të bashkësisë, si fakultative ose e obligueshme. Në këtë mënyrë, do të sigurohej zhvillim i kompetencave gjuhësore, por edhe mundësi e komunikimit në mes të pejsëtarëve të bashkësive të ndryshme.

-Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta për të gjithë studentët, pavarësisht nga ajo se a bëhet fjalë për ato akademike (p.sh. ligjërimin të profesorëve mysafirë) ose joakademike (aktivitete sportive, organizime studentore dhe klube, festa). Në këtë mënyrë do të stimulohej integrimi joformal i studentëve.

5. Zhvillimi i arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc duhet të ketë kujdes për **dimensionin social** të arsimit. Nga njëra anë, kjo do të thotë se kujdes i posaçëm duhet t'iu kushtohet mundësive të qasjes ndaj arsimit që kanë pjesëtarët e grupeve të ndryshme të rrezikuara dhe të marginalizuara (gratë/vajzat, Romët, personat me nevoja speciale). Nga ana tjetër, duhet patur kujdes për atë se qëllimi i arsimit të lartë nuk është vetëm zhvillim ekonomik individual dhe regional, por që edhe ajo- bashkë me nivelet tjera të arsimit- shërben edhe të stimulojë mundësinë për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe marrjen e vendimeve me rëndësi për bashkësinë. Në këtë kuptim, zhvillimi i arsimit të lartë duhet t'i kontribuojë jo vetëm aftësimin për punë por edhe kompetencave më të gjera shoqërore sic është aftësia e mendimit kritik dhe shqyrtimi i problemeve, përkujdesi për veten dhe të tjerët, dhe pjesëmarrja në marrjen e vendimeve. Në këtë kuptim mund të zhvillohen:

-Programe promovuese të arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc që do të jenë të orientuara direkt tek grupet e rrezikuara, respektivisht në informimin dhe sigurimin e mundësive të zgjedhjes kur është fjala për arsimin e lartë;

-Programet e përkrahjes ndaj grupeve të marginalizuara dhe grupeve të rrezikuara në qasje dhe arritjen e arsimit të lartë, qoftë përmes ekzistimit të kuotave, përkrahjes gjatë studimeve (ndihmë e njëhershme në të holla, këshilla) ose stipendi të cilat nuk do të jenë domosdo të bazuara në merita, por në nevoja (merit- based vs. needs-based). Programe të tilla të përkrahjes mund të zhvillohen si në nivel të shtetit dhe komunës, ashtu edhe në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare;

-Elementet e procesit mësimor dhe jetës studentore që do të jenë të orientuara në zhvillim të mendimit kritik, participim studentor, punë vullnetare ose bamirëse, kujdesin për veten ose për të tjerët, etj. Kjo mund të realizohet përmes punëtorive, debateve, diskutimeve, punës së organizatave studentore dhe klubeve, akcioneve, etj. Ajo që është me rëndësi është se një lloj i tillë i aktivitetit, përveç stimulimit të integritetit të studentëve, do t'i kontribuonte kontributit të tyre aktiv ndaj ambientit dhe bashkësisë të cilës i takojnë, pasi që këto aktivitete do të mund t'i dedikohen edhe bashkësisë së gjerë nga ajo akademike. Në këtë mënyrë, arsimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc do të mund të bëhej pjesë integrale e bashkësisë së cilës i kontribuon dhe zhvillohet bashkë me të.

Përfundim i përgjithshëm që mund të bëhet është se zhvillimi i arsimit në Preshevë dhe Bujanoc bart potencial të madh, jo vetëm në kuptim të zhvillimit ekonomik të këtij regjioni- por- ndoshta edhe më me rëndësi- në kuptim të zhvillimit të integritetit shoqëror dhe kualitetit më të mirë jetësor. Në këtë kuptim, këtij procesi duhet t'iu qasemi me kujdes, duke shqyrtuar

nevojat dhe mundësitë si të regjionit ashtu edhe të të gjitha palëve të interesuara. Vetëm në këtë mënyrë arsimit i lartë në Preshevë dhe Bujanoc do të mund të realizojë atë që e ka për qëllim- ardhmëri të përbashkët dhe më të mirë për të gjithë qytetarët.